



Prishtinë: 24.09.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1043_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1853_08_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **13.09.2018**.

në seancën e mbajtur më datë 24.09.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHE**T ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin J. S. nga Mitrovica, me shifër të konsumatorit: DMI - 9034608, si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1853_08_18 i datës 27.08.2018.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 13.09.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se faturimi i bërë në periudhën 12/2013 deri më 11/2015 është real. Në ankesë theksohet se konstatimi i organit të shkallës së parë se konsumatori në periudha të njëjta ka shpenzim të ndryshëm nuk është bindës. Në ankesë është theksuar se nëse këto periudha merren për bazë për korrigjim atëherë do të duhej të merrej për korrigjim periudha 6 mujore sipas Kodit të Matjes, dhe për këtë korrigjim KESCO do të pajtohej. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1853_08_18 të datës 27.08.2018 për konsumatorin J. S. me shifër DMI – 9034608.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se faturimi i bërë në periudhën 12/2013 deri më 11/2015 është real, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë shkresave të lëndës ka vërejtur se faturimi i periudhës së lartcekur nuk është real e dëshmon fakti se në përgjigjen e KEDS-it dhënë konsumatorit me datë 02.09.2016 theksohet se njehsorët e pilot projektit kontrollohen vizualisht në



anën e jashtme në distrikt, kontrollohen bllobat, kontrollohen me matje të bobinave dhe nëse nuk ka ndonjë dyshim njehsori mbetet në distrikt për asgjësim, në të kundërtën merret në kalibrim dhe kontrollohen detalisht. Por që me këtë veprim KEDS ka gabuar dhe ke vepruar në kundërshtim me rregullat dhe procedurat në fuqi, kur ka theksuar se njehsori është kontrolluar vetëm në distrikt në mënyrë vizuale dhe janë kontrolluar edhe bobinat, pasi që në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0157044 të datës 24.11.2015 nga punëtorët e autorizuar të inspektimit është theksuar se njehsori është ndërruar me kërkesë të konsumatorit dhe se njehsori duhet të shkoj në kalibrim, ndërsa sipas përgjigjes së KEDS-it, njehsori nr.9060391 është asgjësuar në distrikt, përderisa ndërrimi i njehsorit elektrik është bërë me kërkesë të konsumatorit për të kontrolluar njehsorin elektrik për shkak të dyshimit në matjen e tij. Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se KEDS ka asgjësuar njehsorin elektrik nr.9060391 pa u bërë kontrollimi detal i tij dhe pa u bërë shqyrtimi i saktësisë së matjes.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se konstatimi i organit të shkallës së parë se konsumatori në periudha të njëjta ka shpenzim të ndryshëm nuk është bindës, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron pasi që sipas analizave të bërë shpenzimit të përgjithshëm të energjisë elektrike është konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore, mirëpo gjatë krahasimit të shpenzimeve të energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin elektrik nr.9060391 krahasuar me shpenzimet e regjistruara në njehsorin e ri nr.64673726 konstatohet se konsumatori ka luhatur në shpenzim të energjisë. Duhet theksuar se për periudhën 11/2014 deri në periudhën 10/2015 me njehsorin elektrik kontestues nr.9060391 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë 775.83 kWh/muaj, me njehsorin nr.64673726 prej periudhës 12/2015 deri në periudhën 11/2016 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është 485.42 kWh/muaj. Për periudhën 12/2013 deri në periudhën 10/2015 me njehsorin elektrik kontestues nr.9060391 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike ka qenë 803.78 kWh/muaj, me njehsorin nr.64673726 prej periudhës 12/2015 deri në periudhën 10/2017 mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike është 504.74 kWh/muaj. Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në shpenzimin e energjisë elektrike konstatohet se konsumatori me njehsorin kontestues ka pasur shpenzim më të ulët në krahasim me njehsorin e ri përafro 59%. Bordi i ZRRE-së ka bërë analizimin e shpenzimeve të energjisë elektrike edhe sipas sezonave dhe konstaton konsumatori me njehsorin e ri ka shpenzim më të ulët se sa me njehsorin e vjetër.

Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në shkresat e lëndës, si shpenzimin e energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë, kërkesën e konsumatorit për ndërrim njehsori të datë 16.11.2015, procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0157044 të datës 24.11.2015 ku theksohet se njehsori ndërrohet me kërkesën e konsumatorit dhe njehsori i vjetër duhet të shkoj në kalibrim, përgjigjen e KESCO-s të datës 08.02.2016, asgjësimin e njehsorit elektrik nga ana e KEDS-it, konstaton se KEDS ka gabuar dhe nuk ka respektuar saktë rregullat, procedurat dhe kodet në fuqi me rastin e asgjësimit të njehsorit elektrik të konsumatorit nr.9060391, pasi që ka qenë i obliguar të bëjë kontrollimin e njehsorit elektrik dhe shqyrtimin e saktësisë të tij sipas kërkesës së konsumatorit. Andaj duke pasur parasysh se KEDS ka bërë asgjësimin e njehsorit elektrik dhe nuk mund konstatohet gjendja e njehsorit elektrik kontestues nr.9060391 si dhe duke pasur parasysh se konsumatori me njehsorin e ri është duke shpenzuar më pak se me njehsorin e vjetër, konstaton se KESCO duhet që konsumatorin me shifër DMI – 9034608 ta korrigoj për një periudhë 24 mujore, pra nga periudha 12/2013 e deri më datën e ndërrimit të njehsorit elektrik 24.11.2015, dhe se korrigjimi duhet të bëhet duke marrë për bazë për faturim shpenzimin e njëjtë muaj për muaj të energjisë elektrike të njehsorit të ri elektrik nr.64672726 të periudhës 12/2015 deri më 11/2017. Duhet theksuar dispozita ligjore 4.11 Defektet në Matje dhe Saktësi të Matjes ka të bëjë kur njehsori elektrik dërgohet në qendrën e kalibrimit dhe bëhet shqyrtimi i tij, dhe jo në rastet kur njehsori elektrik agjësohet nga vet



KEDS-i pa e dërguar në laborator, andaj edhe vendimi i organit të shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në dispozita ligjore të Rregullave në fuqi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Jahir Sejdiu, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.